LIGJ
Nr.9622, datë 16.10.2006

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES USHTARAKE GRANT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ushtarake grant ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5096, datë 2.11.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE USHTARAKE GRANT
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Turke, duke riafirmuar marrëdhëniet e gjata ekzistuese të miqësisë;

- *duke iu referuar* Marrëveshjes së bashkëpunimit në fushën ushtarake të stërvitjes, teknikës dhe shkencës, nënshkruar më 29.7.1992 dhe Marrëveshjes së bashkëpunimit dhe trajnimit ushtarak, nënshkruar më 19.11.1992;

- *me qëllim* forcimin e bashkëpunimit ushtarak dhe kontributit për ristrukturimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë,

bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Qeveria e Republikës së Turqisë do t'i dhurojë 1 360 000 (një milion e treqind e gjashtëdhjetë mijë) lira të reja turke të barasvlefshme në dollarë amerikanë, Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Granti do të jetë i vlefshëm për vitin 2006.

Neni 2

1 360 000 (një milion e treqind e gjashtëdhjetë mijë) lira të reja turke e barasvlefshme në dollarë amerikanë do të sigurohen si materiale dhe shërbime, në përputhje me rregullat në fuqi të Republikës së Turqisë.

Neni 3

1 360 000 (një milion e treqind e gjashtëdhjetë mijë) lira të reja turke e barasvlefshme në dollarë amerikanë do të realizohen në përputhje me protokollin e zbatimit logjistik dhe do të nënshkruhet ndërmjet autoriteteve të të dyja Palëve referuar kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4

Republika e Shqipërisë bie dakord të mos ia transferojë titujt, materialet, shërbimet një vendi apo pale të tretë pa pasur më parë miratimin e Republikës Turke.

Neni 5

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën kur Palët kanë shkëmbyer ndërmjet tyre njoftimet me shkrim, duke deklaruar se marrëveshja është ratifikuar në përputhje me procedurën e tyre ligjore dhe do të jetë në fuqi derisa të gjitha materialet dhe shërbimet e specifikuara në protokollin e zbatimit i janë dhënë Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë.

Marrëveshja grant do të zbatohet nga Ministria e Mbrojtjes në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe nga Shtabi i Përgjithshëm Turk në emër të Qeverisë së Republikës Turke.

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet nëpërmjet diskutimeve dhe negociatave reciproke.

Kjo Marrëveshje është përgatitur në gjuhët turqisht, anglisht dhe shqip. Në rast të mosmarrëveshjeve lidhur me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, versioni në anglisht do të jetë prioritar.

Kjo Marrëveshje u nënshkrua më 12 korrik 2006 në Ankara/Turqi.

NË EMËR TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve të Mbrojtjes **Kolonel** **Perikli Koliçi**	NË EMËR TË QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË Drejtor i Departamentit të Planizimit dhe Menaxhimit të Burimeve të Mbrojtjes të SHPFA të Turqisë **Gjeneral Brigade** **Ali Akdogan**